




REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
 01 Nr. /2025

Datë: 31.07.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.110/04-29365 i datës 28.12.2022, si dhe në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe me Ligjin Nr.05/L-009, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025, pas diskutimeve lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për mbështetje Financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit “ SH.A, e miratoi këtë:

V e n d i m

Për

mbështetje Financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit “ SH.A

1. Aprovohet Propozim Vendimi për Mbështetje Financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit“ SH.A, në Gjakovë me qëllim të furnizimit me lëndën e parë të Biomassës për përmbylljen e sezonit 2024-2025.
2. Mjetet për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit“ SH.A të ndahen nga Kategoria e Subvencioneve të Zyrës së Kryetarit të Komunës nga Kodi Buxhetore 10/632/16016/200/00000/0111, dhe kodi 21/632/16016/200/00000/0111 në vlerë prej 200,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.

Arbënesha Kuqi
 Kryesuesja e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	11.07.2025 <u>01-400/05-35999</u>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A

Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, me datën 11.07.2025 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A, me qëllim të furnizimit me lëndën e parë të Biomasës për përmbylljen e sezonit 2024/2025.
2. Mjetet për mbështetje financiare për Ndërmarrjen, të ndahen nga kategoria e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit nga kodi buxhetor 10/632/16016/200/00000/0111 dhe 21/632/16016/200/00000/0111, në vlerë prej 200,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Propozim -Vendimi.

Me respekt!



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" pn Rezinë, Gjakovë
Tel: +383 (0) 46 127 066
E: Info@ngrohtorja.org

NUI: 811326471

web:www.ngrohtorja.org

Me: 16.06.2025

Nr.398

Për: Kuvendi Komunal Gjakovë
Kryetarin e Komunës
z. Ardian Gjini

Nga: NP Ngrohtorja e Qytetit SHA Gjakove
Kryeshef Ekzekutiv
z. Blerim Halilaj

KERKESE

I nderuar Z. Gjini

Ne bazë te planifikimit buxhetor nga Komuna e Gjakovës për vitin 2025 janë planifikuar mjetet për te subvencionuar lenden e pare djegëse Biomase për Ngrohtoren e Qytetit SHA Gjakove.

Me këto mjete ndërmarrja planifikon mbulimin e shpenzimeve te blerjes se lendes se pare djegëse Biomase për vitin 2025 përgjatë sezonit 2024/2025. (Sezoni ka qene e plote konkretisht 15 tetor – 15 prill)

Duke vlerësuar larte mbështetjen e vazhdueshme qe keni treguar për Ngrohtoren përgjatë viteve te kaluara, dhe duke marre parasysh faktin se ne vitin 2024 e keni mbështetur ngrohtoren ne shumen prej 300.000 Euro Subvencion.

Kërkojmë nga ana juaj lejin e shfrytëzimit te këtyre mjeteve te planifikuara për vitin 2025.

Mirënjohës për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen institucionale, dhe presim përgjigjen tuaj

Me respekt
Ngrohtorja e Qytetit Gjakove

